

VENDIM
Nr.409, datë 23.1.2006

PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË SUBJEKTIT TELEVIZIV VENDOR “TV KOMBI”

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, “Rregullores mbi procedurat e rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, të vendimit nr.403, datë 30.11.2005 të KKRT-së, si dhe kërkesës së subjektit të interesuar, Këshilli Kombëtar i Radios dhe i Televizionit

VENDOSI:

1. Të miratojë ndryshimet e të dhënave të paraqitura në kërkesën për marrjen e licencës nga ana e subjektit televiziv vendor privat “TV Kombi”, si dhe pasqyrimin e këtyre ndryshimeve në licencën e subjektit.
2. Në mbarim të afatit të licencimit, sipas licencës nr.016/TVL, të rinovojë për një afat të ri 5-vjeçar në fushën e transmetimeve televizive tokësore analogjike, subjektin televiziv “TV Kombi”.
3. Kushtet e licencës, sipas pikës 2 të këtij vendimi, mbeten të pandryshuara.
4. Ky vendim hyn në fuqi në datën 8.11.2005 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Halil Lalaj